



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 15, datë 30.03.2020

**PËR
PËR MIRATIMIN E FONDIT TË EMERGJENCËS CIVILE TË BASHKISË
DURRËS ME VLERË 45'000'000 LEKË PËR VITIN 2020**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, të Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKB Nr. 647, datë 23.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2020 si dhe Projekt-Buxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2020-2022” dhe në zbatim të shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23198/1, datë 24.12.2019, protokolluar pranë Bashkisë Durrës me nr.18664 Prot., datë 30.12.2019, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit, me propozim të Zëvendëskryetarit Bashkisë z. Zhuljen Varfaj, i cili kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e fondit të emergjencës civile të Bashkisë Durrës me vlerë 45'000'000 (dyzetepesëmilion) lekë për vitin 2020.
2. Ky fond do të alokohet në programin e emergjencave civile dhe do të përdoret për përballimin e situatave në raste të emergjencave.
3. Ky fond do të merret nga të ardhurat e trashëguara nga viti i mëparshëm 2019.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjithë Drejtoritë e Bashkisë Durrës si dhe Institucionet në varësi të saj.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 30.03.2020